



Këshilli i Ministrave ndryshon masat e veçanta të ndërmarra për veprimtarinë gjyqësore në kuadër të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19

Në Fletoren Zyrtare nr. 98 datë 29 Maj 2020 është botuar Akti Normativ me fuqinë e ligjit i Këshillit të Ministrave nr. 21, datë 27.05.2020 "Për disa ndryshime në aktin normativ nr. 9, datë 25.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19", miratuar me Ligjin nr. 30/2020" ("Akti Normativ nr. 21").

Akti Normativ nr. 21 hyn në fuqi menjëherë.

Akti Normativ nr. 21 përcakton disa ndryshime të rëndësishme në lidhje me zhvillimin e seancave gjyqësore dhe afatet për veprimet procedurale, të cilat ishin efektivisht të pezulluara (përveç disa rasteve përjashtimore):

- Seancat gjyqësore në çështjet administrative, civile dhe penale do të realizohen gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, në përputhje me masat organizative specifike për të shmangur grumbullimet në ambientet e gjykatave dhe brenda sallave gjyqësore. Rregullat për këtë qëllim do të miratohen nga këshillat dhe organet e administrimit gjyqësor të çdo gjykate, jo më vonë se (pesë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij Akti Normativ nr. 21.
- Afatet procedurale të pezulluara më herët për ngritjen e padive, për paraqitjen e ankimeve, si dhe për kryerjen e çdo veprimi procedurale në çështjet administrative, civile dhe penale, do të vazhdojnë të llogariten nga data e hyrjes në fuqi të Aktit Normativ nr. 21 për pjesën e paplotësuar të afatit. Ndërsa, afatet që duhet të fillonin gjatë kësaj periudhe të pezullimit fillojnë të llogariten sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin përkatës nga data e hyrjes në fuqi të këtij akti normativ.

Gjithashtu, Akti Normativ nr. 21 parashikon mundësinë e zhvillimit të seancave gjyqësore me pjesëmarrjen e palëve, përfaqësuesve apo personave të tjerë nëpërmjet ndërlidhjes audiovizive duke përdorur programe kompjuterike të përshtatshme për këtë qëllim, për aq sa është e mundur dhe vetëm pasi palët kanë dhënë pëlqimin. Në këto raste, palët do t'i paraqesin provat, dokumentet shkresore dhe çdo akt tjetër procedural nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik dhe brenda të njëjtës ditë nëpërmjet shërbimit postar.

Vlen të theksohet se, Akti Normativ nr. 21 parashikon që seancat në çështjet administrative dhe civile për të cilat nuk kërkohet prania e palëve, të kryhen mbi bazë dokumentesh dhe nëpërmjet përdorimit të mjeteve të komunikimit elektronik, si për paraqitjen e akteve procedurale, ashtu edhe për dhënien e vendimit nga gjykata.



The Council of Ministers makes significant changes to the special measures taken for the judicial activity in the context of the epidemic caused by COVID-19

In the Official Gazette no. 98 dated 29 May 2020 it was published the Normative Act with the effect of a law no. 21, dated 27.05.2020 "On some amendments to the normative act no. 9, dated 25.3.2020, of the Council of Ministers "On the enactment of special measures for the judicial activity, during the epidemic caused by COVID-19", approved by Law no. 30/2020" ("Normative Act no. 21").

The Normative Act no. 21 enters into force immediately.

The Normative Act no. 21 makes significant changes with regard to the conduct of court hearings and the suspended statute of limitations, which were effectively suspended (subject to certain exceptions):

- The court hearings in administrative, civil and criminal cases will be conducted during the duration of the epidemic caused by COVID-19, in accordance with the specific organizational measures to avoid the crowding of people in the premises of the courts and in the courtroom. For this purpose, the rules will be enacted by the administrative bodies and councils of the courts, not later than 5 (five) days from the entry into force of this Normative Act no. 21.
- The previous suspended statute of limitations for filing lawsuits, appeals, and the performance of other procedural acts in administrative, civil and criminal cases, will recommence and will be calculated as usual from the entry into force of the Normative Act no. 21. Meanwhile, the statute of limitations which were about to begin during this period of suspension, will start to be calculated upon the entry into force of Normative Act no. 21.

Furthermore, the Normative Act no. 21 provides the possibility to conduct court hearings, with the participation of the parties, representatives and other persons via audio visual links with appropriate computer programs for this purpose, to the extent it is possible and subject to the approval of the parties.

In these cases, the parties will submit the evidences, written documents and other procedural acts through electronic means and within the same date file those with the postal service.

It should be noted that, the Normative Act no. 21 provides that the court hearings in administrative and civil cases, which do not require the presence of the parties, may be conducted on the basis of documents only and via electronic means for the submission of the procedural acts, as well as for the issuance of decision from the court.